



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

Bashkia Lezhë, L. "Skënderbej", Sh. "Gjergj Kastrioti", 4501 Lezhë, Nr. Tel. 00355 215 22270, e-mail: f.frrokaj@lezha.gov.al

V E N D I M

Nr. 207, Datë 28/10/2016

Për disa ndryshime të V.K.B Nr.148, datë 06.06.2016 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2016"

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", të ligjit Nr.8399, datë 09.09.1998 "Për Buxhetin Lokal", i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit Nr.147/2015 "Për Buxhetin e vitit 2016", të Udhëzimit M.Financave Nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të Udhëzimit M.Financave Nr.1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e Buxhetit për vitin 2016", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe të VKB Nr.148, datë 06.06.2016 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2016", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkisë;

V E N D O S I :

1.Miratimin e ndryshimeve të V.K.B Nr.148, datë 06.06.2016 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2016", si më poshtë;

1/1.Bëhen këto shtesa të strukturës dhe fondit të investimeve për shumën 87.500.000 lekë:

- Rikonstruksion i rrugës Barbulloje e Re me gjatësi 2 km me vlerë 30.000.000 lekë.
- Rikonstruksion i rrugës Sektori i Vjetër Gjadër + Rikonstruksion i rrugës varrezave në fshatin Zojs + Ndërtim varrezash në fshatin Gjadër me vlerë 10.000.000 lekë.
- Ndërtim Prita Malore në fshatin Manati me vlerë 3.500.000 lekë.
- Rikonstruksion i rrugës Blinisht-Baqel me vlerë 33.000.000 lekë.
- Riparim rrugë të brendshme në fshatrat Dragushë dhe Gramsh me vlerë 1.000.000
- Shpronësim objekti në favor të z.Mark Doda me vlerë 10.000.000 lekë.

1/2.Bëhen këto pakësime të strukturës dhe fondit të investimeve për shumën 87.500.000 lekë:

- Sistemim sheshi dhe ndërtim KUZ në fshatin Tresh me vlerë 17.000.000 lekë.
- Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Kodhel me vlerë 5.000.000 lekë.
- Rikonstruksion i zyrave të administratës tek ish-banka me vlerë 10.000.000 lekë.
- Likujdim investimesh të prapambetura me vlerë 8.000.000 lekë.
- Rikonstruksion i rrugës Barbulloje e Re me gjatësi 1 km me vlerë 15.000.000 lekë.
- Shpronësime me vlerë 10.000.000 lekë.

- Blerje automjeti për administratën me vlerë 4.000.000 lekë.
- Rikonstrukcion i rrugës Kotërr – Dajç me vlerë 18.500.000 lekë


Veprimi të kryhen në; Gr. 00, Prog. 01110, Kap.01, Llog.Ek. 231 për shumën 55.500.000 lekë;
Gr. 00, Prog. 01110, Kap.05, Llog.Ek. 231 për shumën 22.000.000 lekë;
Gr. 00, Prog. 01110, Kap.05, Llog.Ek. 604 për shumën 10.000.000 lekë;

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Gjok NDOKA



Nr. ____ Prot, Datë ____ / ____ /2016

Kryetarit të Bashkisë Lezhë
Prefektit të Qarkut Lezhë
Arkivës së Bashkisë
Degës së Thesarit Lezhë

SEKRETARI I KËSHILLIT

Jerina VATAJ

